



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:265759
Datë: 10.05.2024
Numri i dokumentit: 05670764

Pml.nr.246/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurve: Xh. H., nga L. dhe A. P., nga fshati ..., komuna e L., për shkak të veprës penale “Lëndimi i lehtë trupor”, nga neni 185, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të të dëmtuarit M. H., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, P.nr.559/2023, të datës 12.12.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.72/2024, të datës 20.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 24.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si e papranueshme kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të dëmtuarit M. H., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, P.nr.559/2023, të datës 12.12.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.72/2024, të datës 20.02.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, P.nr.559/2023, të datës 12.12.2023, të dënuarit: Xh. H. dhe A. P., janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Lëndimi i lehtë trupor”, nga neni 185, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe ndaj secilit prej të dënuarve është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej nga treqind (300) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse të dënuarin, në periudhën e verifikimit prej një (1) viti, nuk kryejnë ndonjë vepër penale tjetër. Të dënuarit: Xh. H., dhe A. P., janë liruar nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale, për arsye se të njëjtit

janë në gjendje të dobët ekonomike dhe se pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të të njëjtëve ose të personave që ata detyrohen që t'i mbështesin materialisht. I dëmtuari M. H., nga fshati ..., komuna e Sh., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.72/2024, të datës 20.02.2024, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të dëmtuarit M. H., ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve të gjykatave të instancave më të ulëta, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur i dëmtuari M. H., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimet e lartcekura të ndryshohen, ashtu që ndaj të dënuarve: Xh. H. dhe A. P., të shqiptohen dënime më të ashpra apo aktgjykimet në fjalë të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, me parashtresën KMLP.II.nr.137/2024, të datës 19.04.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të hedhet si e papranueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e papranueshme.

Në nenin 433, paragrafi 1 të KPP-së është parashikuar se *“Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqesë Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Pas vdekjes së të pandehurit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë në nenin 424, paragrafi 1 të këtij Kodi”*.

Andaj, bazuar në këtë dispozitë ligjore, rezulton se pala e dëmtuar nuk mund të paraqesë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, por që të njëjtën mund ta paraqesë Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, ndërsa pas vdekjes së të pandehurit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë në nenin 424, paragrafi 1 të KPP-së.

Duke u bazuar në arsyet e paraqitura më lart dhe në bazë të nenit 435, paragrafi 2 lidhur me nenin 434, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.2. të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.246/2024, më datë 24.04.2024

Procesmbajtëse,
Qefsere Berisha

Kryetare e kolegjit,
Valdete Daka